



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Raporti

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Takimet

Me të pranuar vendimin e kryetarit të Komunës së Kaçanikut për formimin e grupit punues për Draft dokumentin Rregulloren PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË SHTËPISË SË KULTURËS “XHELADIN KURTAJ “NË KOMUNËN E KAÇANIKUT, grupi punues ka mbajtur 3 takime në të cilat ka finalizuar draftin final të kësaj draft rregulloreje .

Pas përfundimit të punës së këtij grupi punues sipas vendimit të kryetarit ky draft është përcjellur tek organet komunale për publikim në web faqe ku pastaj i njejtë është debatuar edhe në diskutimin publik më datë 29.05.2023.

Publikimi në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike

Komuna e Kaçanikut përmes Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe nenin 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, ka lëshuar këtë: KONSULTIM PUBLIK -Lidhur me konsultimin publik për Rregulloren PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË SHTËPISË SË KULTURËS “XHELADIN KURTAJ “NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

Ky dokument public ishte në diskutim publik nga data 15.05.2023 deri më 29.05.2023, ndërsa konsultimi publik u mbajt me 29.05.2023 në sallën e Kuvendit Komunal, në objektin e administratës komunale, nga ora 11:00. Komentet dhe sugjerimet janë oranuar deri me datën 29.05.2023, në ora 16:00, tek drejtori i Shtëpisë së Kulturës “ Xheladin Kurtaj” Muharrem Ahmetaj, në email adresën: muharrem.ahmetaj@rks-gov.net.

Në Diskutimin Publik të mbajtur më datë 29.05.2023 në Sallën e Kuvendit komunal sipas procesverbalit u dhanë këto Komentet:

29.05.2023

Procesverbal rreth diskutimit publik me temë „Draft Rregullorja për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Shtëpisë së Kulturës së Kulturës „Xheladin Kurtaj” në Komunën e Kaçanikut

Mbledhjen e kryesoi **Muharrem Ahmetaj**-Drejtor i Shtëpisë së Kulturës ndërsa prezent ishin edhe anëtarët e Komisionit për përpilimin e kësaj draft rregulloreje.

Proces mbajtës u propozua **Fatmir Qaka**-pjesë e stafit të DKRS-së

Pjesmarrës në këtë diskutim publik ishin përfajqsues nga OJQ të cilët gravitojnë në këtë objekt dhe si temë diskutimi ishte shqyrtimi i kësaj draft rregulloreje para se kjo draft rregullore të dalë në kuvend për miratim.

Muharrem Ahmetaj si kryesues i këtij diskutimi publik së pari njoftoi të pranishmit se kjo draft rregullore ka qenë e shpallur në faqën e komunës që çdo kush ka pasur kohën për ta lexuar dhe sot të jenë të gatshëm për të dhënë ndonjë sugjerim por që prap ne jemi këtu për tu konsultuar apo për të pranuar ndonjë sugjerim nga ju që kjo draft rregullore të plotësohet dhe të përcillet për kuvend për miratim.

Pas një prezentimi të shkurtë kryesuesi hapi diskutimin për të pranishmit.

Naim Hysa-kërkoj sqarim rreth nenit 12 pika 2.6 dhe 2.7-a mundë të ceket që edhe Kryqi i Kuq të jet pjesë e subjekteve që nuk obligohet pagesa dhe qështja e parkingjeve a mundë të shfrytëzohen nga ata të cilët kanë zyre me kontratë. Gjithashtu dhënja e hapsirës për një vit a ka ndonjë qmim.

Muharrem Ahmetaj-ka arsye që të përmendet edhe Kryqi i Kuq ngase ka një kontratë me komunë për shfrytëzimin e zyrës e gjithashtu është shoqatë humanitare. Parkingjet mundë të i shfrytëzojnë të gjitha subjektet që kanë zyre me kontratë nga komuna.

Fatos Vishi-dhënja e hapsirës me qira është e përcaktuar në këtë draft rregullore në nenin 8.

Izedije Gula-jemi një organizatë që para pak kohësh jemi themeluar dhe kemi bërë një kërkesë për zyrë pran DKRS por që ende nuk kemi pranuar ndonjë përgjigje.

Fatos Vishi-koha kur ju keni bërë kërkesë për zyrë ka qenë në fazën e përpilimit të draft rregullorës dhe pas miratimit të kësaj rregulloreje nga kuvendi do ta keni edhe përgjigjen duke u bazuar në këtë rregullore.

Muharrem Ahmetaj-pas miratimit të kësaj rregulloreje në kuvend atëherë edhe ne do ta kemi një bazë për të vepruar në shqyrtimin e kërkesave nga palët e interesuara në shfrytëzimin e këtij objekti.

Afrim Fuga-çështja e shfrytëzimit të hapsirave me pagesë , a vlenë për të gjithë që e shfrytëzojnë kët objekt apo vetëm për ata që e shfrytëzojnë për përfitime.

Muharrem Ahmetaj-kjo çështje gjithashtu është e përcaktuar në kët draft rregullore.

Elmihane Krasniqi-e di që kjo draft rregullore ka qenë prezente në rrjetet sociale edhe në faqën e komunës por që nuk e kam lexuar dhe më intereson të dijë se deri kur ne mundemi të japim ndonjë sugjerim.

Fatmir Qaka-në njoftimin publik të komunës diskutimi publik ka qenë për sot ora 11:00 por që u është dhënë edhe një mundësi që edhe pas këtij diskutimi deri ora 16:00 ju mundë të dërgoni ndonjë koment apo sugjerim në një adresë që e kemi shënuar në njoftim.

Diskutime tjera nuk pati dhe kryesuesi e përmbylli kët takim me shpresë që kjo rregullore të miratohet në seancën e radhës së kuvendit komunal me qëllim që palët e interesuara për shfrytëzimin e këtij objekti të jenë më mirë të informuar gjat përpilimit të kërkesave të tyre.

Në përfundim pas marrjes së kërkesave dhe diskutimit publik u morë për bazë kërkesa e Naim Hysa që të futet në nenin 12 pika 2.6 dhe 2.7-a që edhe Kryqi i Kuq të jet pjesë e subjekteve që nuk obligohet pagesa për aktivitetet dhe qështja e parkingjeve sipas këtyre neneve.


Kryesues:

Muharrem Ahmetaj



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka



Hafize Sallahi

Drejtoreshë e D...

